



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Komuna e Drenasit

Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit



08-Nr. 030-4052 dt. 23.01.2019

Plani dhe programi i punës për vitin 2019

Drenas, janar 2019

Në mbështetje të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe në vështirim të nenit 76 pika 1, të Statutit të Komunës së Drenasit, dhe nenit 81 Drejtori i Drejtoratit për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit paraqet këtë:

PLANI DHE PROGRAMI I PUNËS PËR VITIN 2019

Detyrat e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit

- Menaxhon me Planet Hapësinore të Komunës (Planin Zhvillimor Komunal, Hartën Zonale të Komunës dhe planet rregulluese të hollësishme),
- Lëshon leje ndërtimore sipas ligjeve dhe udhëzimeve administrative në fuqi,
- Udhëheqë procesin e legalizimit të objekteve sipas ligjeve dhe udhëzimeve administrative në fuqi,
- Harton kriteret për dhënien me qera të objekteve komunale dhe tokës ndërtimore të Komunës,
- Harton programe, detyra projektuese me ndihmën e ekspertëve të përzgjedhur për organizimin e konkurseve urbanistiko-arkitektonike,
- Koordinon dhe menaxhon mbledhjen e informatave për GIS nga organizatat dhe drejtoratet tjera të Komunës,
- Mban evidencën për emërtimet e vendbanimeve, rrugëve, shesheve si dhe numrat e objekteve dhe shtëpive brenda territorit të Komunës (sistemi Aris),
- Kujdeset për ruajtjen e mjedisit,
- Harton rregullore dhe plane të ndryshme për çështje mjedisore, zbatimimi i legjislacionit dhe raportimi, marrja e të dhënave nga drejtoratet tjera që kanë të bëjnë me çështje mjedisore,
- Merret me menaxhimin e objekteve banesore,
- Kryen edhe punë të tjera në përputhje me ligjet e aplikueshme në kuadër të fushëveprimtarisë së Drejtoratit.

Duke u bazuar edhe në përvojën e viteve të kaluara, plani vjetor i punës për vitin 2019 është hartuar me kujdes, në mënyrë që të jetë i kompletuar në aspektin e implementimit gjatë tërë vitit.

Funksionimi i Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit mbështetet në dy sektorët e saj:

- Sektori për Planifikim Urban
- Sektorit për Mbrojtje të Mjedisit

Në kuadër të këtyre sektorëve shqyrtohen kërkesat e qytetarëve siç janë: Lejet ndërtimore, Lejet e rrënimit, Kushtet ndërtimore, Lejet mjedisore komunale, Pëlqimet, Vërtetimet Urbanistike, Njoftime dhe shkresa të ndryshme rreth zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe Planeve të tjera rregulluese, si dhe mbrojtjes së mjedisit.

Prioritetet dhe synimet e Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për vitin 2019 janë:

- Shqyrtimi i kërkesave të palëve në afat minimal ligjor,
- Rritja e të hyrave vetanake përmes lëshimit të lejeve ndërtimore dhe lejeve mjedisore komunale,
- Përgatitja e kërkesave fillestare për planifikim të buxhetit,
- Përfundimi i hartimit të Planit Zhvillimor Komunal, i nisur në vitin 2018,
- Hartimi i Hartës Zonale të Komunës së Drenasit dhe planeve rregulluese të hollësishme, dhe vendosja e tabelave informuese,
- Hartimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis, me pjesëmarrjen e ekspertëve dhe qytetarëve,
- Hartimi i Planit Lokal për strategjinë e cilësisë së ajrit,
- Digjitalizimi i të dhënave për shtrirjen dhe emërtimin e rrugëve dhe numërtimin e hyrjeve të objekteve në sistemin Aris,
- Vendosja e tabelave për emërtimin e rrugëve, vendosja e numrave në hyrje të objekteve,
- Pjesëmarrja në Zyren e Prokurimit në hapje dhe vlerësimin e ofertave të ndryshme,
- Mbledhja e të dhënave dhe plotësimi i formularëve për performancë komunale,
- Udhëheqja e procesit të legalizimit të objekteve sipas ligjeve dhe udhëzimeve administrative në fuqi,
- Hartimi i kriterëve për dhënien me qera të objekteve komunale dhe tokës ndërtimore të Komunës,
- Përgatitja e projekt propozimeve për financimin e projekteve nga donatorët,

- Kordininimi dhe menaxhimi në mbledhjen e informatave për GIS nga organizatat dhe drejtoratet tjera të Komunës,
- Rritja e përkushtimit në mbrojtjen e mjedisit,
- Përkrahja e iniciativave në ruajtjen e mjedisit, shënimi i ditëve ndërkombëtare të tokës, ujit, mjedisit etj.

Drenas, janar, 2019



Drejtori për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit
Elitura Avdiu